



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot

Bilisht, më _____._____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rehabilitimi i përroit të Kallabaqit Bitinckë”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: Punime ndertimi per
kullim -45232453-2**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **15,432,642 (pesëmbëshjetë milion e katërqind e tridhjetë e
dy mijë e gjashtëqind e dyzet e dy) leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vertetim të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për 3 vitet financiare 2023,2024,2025 ,ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar **duhet të jo më e vogël se vlera e perlllogaritur e kontratës objekt prokurimi.**

*** Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenit 43, pika 2-b e VKM-se, nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku përcaktohet se; **”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”**

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,ku përcaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”*.

Ligjin nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Fondi limit = 15,432,642 (pesëmbëshjetë milion e katërqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e dyzet e dy) leke pa tvsh procedure prokurimi ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar sipas kufijve të përcaktuar në VKM-ne Nr. 291 datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik ” i ndryshuar KREU II

2.2.2. Për të vërtetuar një aktivitet të qendrueshëm Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar,

****Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar). Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Pushteti Vendor, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetin sipas të dhënave të QKB-se për kestat e maturuara për vitin 2026.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument në momentin e dorëzimit të dokumentave).

Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për kestat e maturuara për vitin 2026.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosija e kërkesës për detyrimet vendore është bërë në mbështetje të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Shlyerja e detyrimeve vendore për operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrorjnë aktivitetin e tyre ekonomik në përputhje me rregullat e përcaktuara nga autoritetet vendore nëpërmjet Vendimeve të Këshillave Bashkiak.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

-Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

a.Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës , shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- Aktin e kolaudit;
- Certifikatën e marrjes në dorezim të perkohshëm/përfundimtar.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
 - Akt kolaudimi objekti.
- ✓ Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin e sipërcituar për secilin rast respektivisht duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes të punimeve ku të cilësohen punimet që ka marrë persiper të kryese secili anëtar i BOE.
- ✓ Për kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

a) Kontratë baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe

b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Në rastin e Bashkimit të operatoreve ekonomike, Operatorët duhet të përmbahen përcaktimeve të nenit 88 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar

Argumentimi: AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ku qartazi përcaktohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve”.*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas DST, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu në Vkm nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 39, pika 8 *autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), udhëzimi i k.m nr.2 , datë 13.05.2005 “për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe udhëzimin nr.3 datë 15.02.2001 “për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e vkm-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vërtetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr. 9, kontratat e sipërmarrjes , situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, çertifikatën e marrjes në dorezim/çertifikatën e përkohshme të marrjes në dorezim për punët e kryera me entet publike, që autoriteti kontraktor të bindet që operatori ekonomik me anë të dokumentacionit të paraqitur plotëson kriterin për punë të ngjashme ku shihen zërat e punimeve që ka realizuar, koha e realizimit , dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes në dorezim të objektit si dhe vlerësimi i dhënë nga autoriteti kontraktor,elemente të nevojshme për të gjykuar për plotësimin e kriterëve për punë të ngjashme.

Në rastet e Bashkimit të Operatoreve, për një vlerësimin sa më real të ofertave, është konstatuar se Komisionet e Vlerësimit të Ofertave hasin vështirësi për vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme për rrjedhojë është e domosdoshme që Operatorët Ekonomik kur paraqesin kontrata të ngjashme, ku janë pjesë e një bashkimi operatorësh duhet të paraqesin gjithashtu dhe marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaceme ku të përcaktohen përqindjet përkatëse.

Në rastet e Nënkontraktimit, kërkohet që vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit për marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga AK. Ky dokumentacion disponohet nga çdo operator ekonomik si në rastin kur ka qene palë në bashkimin e operatoreve ekonomik ashtu dhe në rastet kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk sjell kufizim të pjesëmarrjes së operatoreve ekonomik në tender. Të dyja këto kërkesa I vendosin në kushte të barabarta dhe u japin mundësi për vlerësim, të gjithë operatoreve ekonomik ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit dhe marrëveshjet përkatëse të nënkontraktimit nuk janë të plotësuara sipas kërkesave ligjore. Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturs dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

- **NP-1 A (Punime germimi në toke)**
- **NP-7 A (Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)**
- **N.P. 9 A (Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime)**
- **N.S –1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)**
- **NS-18 A (Punime topogjeodezike)**

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2 dhe 4). gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "**Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.** Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve dhe vlerën

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi ne toke	Punimet sipas preventivit ,zeri 3.45/1;3.46/1;3.87/b; 3.25/a;3.89/b	Niveli A	0- 20 milion lekë
Kategoria NP-7	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje	Punimet sipas preventivit Tub b/a Ø800, fugaturë kanali, porta me mekanizem ngrites(zërat 21,22)	Niveli A	0- 20 milion lekë
Kategoria NP- 9	Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime	Punimet sipas preventivit ,zeri 3.243;3.237;3.249;3.240	Niveli A	0-20 milion lekë
<u>Kategoria NS-1</u>	Punime per prishjen e ndertimeve	Punimet sipas preventivit ,zeri 2.426/4	Niveli A	0- 20 milion lekë
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike	Rilevimet e terreneve sportive sipas kuotave te percaktuara në projekt	Niveli A	0- 20 milion lekë

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt te pakten:

- a. 1(nje)inxhinier Ndertimi
- b. 1(nje)inxhinier Hidroteknik
- c. 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë te siguruar dhe të figurojnë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën **muajin e fundit nga data e hapjes se ofertave** .

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës,Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”,

“e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-se Nr. 285 si dhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie*” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 i ndryshuar

-Inxhinier Ndërtimi është përgjegjës për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e punimeve të preventivit, projektit, specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit. Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar Kategoria NP-7 ;Kategoria N.P. 9, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit** për arsye si më poshte:

Rikonstruksioni i kanalit është një proces teknik kompleks, germimet dhe mbushjet e nevojshme për krijimin e kanalit ujtes, kalimet dhe pjerresite dhe të tjera si keto, si edhe për ndërtimin e strukturave, duhet të behen në format dhe dimensionet e treguara në vizatimet përkatëse. Duhet treguar kujdes i veçantë në dhenien e formës ekzakte të kanalit ujtes, në nivelimin në profilizimin e skarpave. Pjerresite të germimeve dhe mbushjeve duhet të kryhen sipas pjerresise së përshtatshme sipas natyrës dhe karakteristikave fiziko-mekanike të formacioneve.

Inxhinieri i ndërtimit interpreton projektin ,studion gjëndjen ekzistuese të objektit. Siguron që materialet ,zbatimi dhe realizimi në terren i objektit të jetë sipas projektit dhe standarteve në fuqi të zbatimit.

Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndjekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standartet dhe kriteret e zbatimit .

Kërkesa për **1 (një) Inxhinier Hidroteknik** lidhet drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, Përoi Kallabaqit kap një gjatësi prej 1340 m dhe shërben për ujitjen e tokave të fshatit Bitincke të Njësisë Administrative Qendër Bilisht. Aktualisht, kanali është I gjithi jashtë funksionit dhe ka nevojë për ndërtim nga e para. Ka probleme me veprën e marrjes, filtrimet, dëmtime në muret e gurit, mbushje etj. Tereni ku kalon është pjesërisht malor por jo i vështirë për tu gërmuar, në disa raste kërkon përpforcime të shpatit. Aktualisht gjithë tokat bujqësore të këtyre fshatrave nuk ujitën duke ulur ndjeshëm rendimin e prodhimeve bujqësore dhe për rrjedhojë miqësinë e banorëve të kësaj zone. Punimet e parashikuara janë: veshja e perroit me beton, fugatimit, nenkalime të ujit me tombino, ura të kalimit kembësor, mure mbajtëse betoni, porta për kontrollin e prurjeve.. Prania e këtij specialisti është e nevojshme për garantimin e zbatimit korrekt të parametrave hidraulikë të projektit dhe funksionimit të veprës sipas destinacionit të saj.

Nëse objekti do të ishte vetëm gjërmim dhe betonim i thjeshtë, mjaftonte Inxhinieri i Ndërtimit. Por duke qenë se kemi **kanal ujitës dhe vepra vaditjeje**, kërkesa për **1 Inxhinier Hidroteknik** konsiderohet e domosdoshme.

Prania e topografit në objekt është thelbësore :

- Për kryerjen e matjeve dhe rëlevimeve topografike të gjëndjes ekzistuese të kanalit.
- Për vendosjen e piketave sipas profilave gjatësorë dhe tërthorë konform projektit
- Për ndjekjen dhe monitorimin e vazhueshëm të punimeve në vepër për të shmangur devijime të mundshme nga projekti.

2.3.4 Vetdeklarimin nga inxhinieri i ndërtimit, Inxhinierit Hidroteknik dhe Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder, se janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur duke u bazuar në rekomandimin Nr. 6732 datë 21.10.2020 "Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP" si më poshtë: *...autoritetet kontraktore të mbajnë në konsideratë dispozitën sipas Kreut 1/2.1, të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" për përmbushjen e këtij kushti, Krahas vetdeklarimit të operatorit ekonomik që drejtuesi/t teknik të punëve do të jenë të pranishëm në objekt apo se nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera. Me qëllim shmangien e keqinformimit apo paraqitjes të dokumentave me të dhëna të rreme, sa i takon deklaratës që ato japin, së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik, të kërkohej edhe dhënia deklaratës nga vetë drejtuesi teknik i operatorit ekonomik, pra dhënia e një deklaratë personale, e cila do të bashkëshoqërojë deklaratën e subjektit.*

2.3.5 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë drejtuesin teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë si dhe të figurojë në listat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

➤ Inxhinier Ndërtimi 1(një)

Për të vertetuar duhet:

- a) Kontratë pune
- b) Diplomë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM-se Nr. 285 si dhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

I ndryshuar ,Kreut 1/2.1, të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar përcaktohet qartësisht se :

Konkretisht pika 1.2 ku citohet se: **“drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi”** si dhe pikës 2.1 **Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.**

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se është i disponueshëm për realizimin e kontratës, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.6 Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Betonues	4 (kater)	Certifikate Trajnimi/ Dëshmi profesionale
- Hekurthyes	1 (nje)	Certifikate Trajnimi/ Dëshmi profesionale
- Karpentier	2 (dy)	Certifikate Trajnimi/ Dëshmi profesionale
- Punonjes për prerje bimesh	2 (dy)	Certifikate Trajnimi/ Dëshmi profesionale
- Punonjes të thjeshtë ndërtimi	2 (dy)	Me kontratë individuale të punës
- Shofer	2 (dy)	Leje Drejtimi
- Manovrator	2 (dy)	Dëshmi e Aftësisë Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome e shkolles mesme/ Certifikate Trajnimi / Certifikate e Aftësisë Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesiperm **si dhe stafi i mesiperm të figurojë në listepagesat e shoqërisë**

per muajin e fundit nga data e hapjes se ofertave ku punonjësit duhet të figurojnë sipas kodit perkates te profesionit. .

Manovratorët dhe shoferët mund të jenë të kontraktuar posacerisht për të realizuar këto kontrate në rastin kur makineritë janë me qera

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punonjesit në certifikatë/diplomë	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikatës/diplomës	Numri i identifikues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT - (Në rast se leshuesi është institucion privat)
1					
2					
.....					

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-se Nr. 285 si dhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Referuar grafikut të punimeve dhe oreve të punës për çdo proces nevojiten specialistet si më poshtë:

1-Tekniku i ndërtimit është personeli teknik i mesëm që ndihmon në organizimin, kontrollin dhe ndjekjen e punimeve në kantier, nën drejtimin e inxhinierit. Ndjek zbatimin e punimeve sipas projektit dhe preventivit.

2-Betonues nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave 13,14,15,16. Sasia e oreve të punës sipas manualit është $8545.97: 2464 = 8.092775$ punonjës, ndërkohë AK ka kërkuar 4 (katër) punonjës.

3-Hekurkthyesi nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit 15;19. (1 Punonjës)

4-Punonjës për prerje bimësh nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit 2,3, Sasia e orëve të punës sipas manualit është $401.1:176 = 2.278864$ punonjës

5- Punonjes te thjeshte ndertimi 2(Dy) punonjes (Per te ndihmuar specialistet si dhe proceset e tjera te punimeve si prishje, germime ,ngarkim ,shkarkim te inerteve, dhe materialeve të ndërtimit te parashikuara në preventivin e punimeve) 2597.378: 704=3.5 Nderkohe AK ka kërkuar 2 punonjës

6-Manovratore 2 (Dy) punonjes Për drejtimin e mjeteve të rënda të kerkuara për realizimin e kontratës

7-Shofer 2 (Dy) punonjes (Janë kërkuar 2 mjete për transportimin e inerteve nga gërmimet dhe për transportimin e materialeve të nevojshme në objekt)

8-Karpiertier Operatori ekonomik duhet të disponojë jo më pak se 2 (dy) karpiertierë, të cilët do të angazhohen në realizimin e kallepeve për punimeve të betonit/betonarme.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjës që përmbush kriteret për të qenë “Person përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë” gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10 237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” **i cili duhet të figurojë në listëpagesa të shoqërisë të paktën për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave.**

Për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune, dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-se Nr. 285 si dhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike

Argumentimi:Kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM-ne Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”, me ane te ketij kriteri kerkohet qe OE te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates.

Kërkesa per Pergjegjesin per Shendetin dhe Sigurine ne Pune, mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier" i perditësuar . Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: “Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes

Kërkesa për një person përgjegjës për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë lidhet me natyrën e punimeve që përfshijnë gërmime të thella, përdorimin e ekskavatorëve, kamionëve, pajisjeve të kompaktimit, punime betonarme dhe montimin e elementëve hidraulikë, të cilat paraqesin rreziqe për sigurinë e punëmarrësve. Prania e këtij specialisti është e nevojshme për zbatimin e legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe për minimizimin e aksidenteve gjatë realizimit të kontratës

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për **muajin e fundit** nga data e hapjes së ofertave duhet të jetë **20 (njetzet)**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-se Nr. 285 si dhe dokuemntat e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të permbushur kontratën.

Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 18 persona duke përfshirë dhe inxhinieret në listepagesa, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet.

Për të percaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht Vendim nr.216 DT 13.04.2023 „Sistemi I Integruar I Manualit Te Cmimeve Ne Nderitim“ Numri i punonjësve është percaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të permbushur zbatimin e kontratës e cila ka një afat prej 4 muajsh.

Numri i percaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Afati: 4 muaj.

Sasia e oreve të punës sipas manualit është $13,488.04 : 704 = 19.16$ Puntore. (Specialiste dhe punonjes ndihmes)

Nevojiten gjithashtu

2-shofer

2-manovrator

Për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Për sa më lart, Ak ka gjykuar të arsyeshëm që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik, **1 (një) teknik ndërtimi**, **4 (Katër)** betonues; **1 (një)** punonjës hekurkthyes; **2 (dy)** manovrator; **2 (Dy)** shofer; **2 (dy)** punonjës krah, **2 (dy)** punonjës për prerje bimesh, **2 (Dy)** Karpentier, së bashku me **3 (tre)**

inxhineret dhe **1 (nje) punonjesin e sigurisë në punë, = 20 punonjës në total që AK** ka kerkuar ne listpagesa. Ak ka kerkuar numrin minimal të punonjësve të domosdoshëm per realizimin e kësaj kontrate.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj eshte kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarres duhet te diponoje pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, qe nevojiten per ekzekutimin e kontrates:

Nr	Mjetet	Sasia	
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri në 7 Ton	2 cope	Pronesi ose me qera
2	Kamioncinë kapacitet deri në 3.5 Ton.	1 cope	Pronesi ose me qera
3	Ekskavator me goma ose me zinxhire	1 copë	Pronesi ose me qera
4	Betonjere	1 copë	Pronesi ose me qera
5	Fadrome	1 copë	Pronesi ose me qera
6	Autobot	1 copë	Pronesi ose me qera
7	Matrapik	1 cope	Pronesi ose me qera
8	Kompaktues/Tokmak vibrues	1 cope	Pronesi ose me qera
9	Vibrator betony	1 cope	Pronesi ose me qera
10	Pajisje topografike (Total Station/GPS)	1 cope	Pronesi ose me qera

Pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave te VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Per miratimin e Rregullores per sigurine ne kantier”, si më poshtë vijon:

2

Nr.	Pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	20 copë	Në pronësi ose me qera
2	Jelekë me shirita fosforishentë	20 copë	Në pronësi ose me qera
3	Kuti e Ndihmës së shpejtë	2 copë	Në pronësi ose me qera

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.

- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Për mjetet e marra me qera që shenohen në regjistrin publik, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikata për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme)

v.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-se Nr. 285 si dhe dokumentat e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës, cdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve .

1-Mjet transporti vetshkarkues deri në 7 ton (ngarkesa).

Transport dhera $m3 \ 1093.0 \cdot 1.6 = 1748.8$ ton

Totali 1748.8 ton: $704 = 12.13916193$ ton në ditë, mesatarisht 1 rrugë në ditë. Kërkohej 2 mjete me kapacitet deri në 7 ton.

2-Kamioncina nevojitet për transportimin e materialeve në objekt.

3-Betoniera nevojitet për përgatitjen e llaceve dhe betoneve sipas zerave të preventivit, në preventiv zëri nr 13,14,15,16.

4-Eskavatori nevojitet për realizimin e punimeve të gërmimit, në preventiv zëri nr 6,9 .

5-Matrapik nevojitet për kryerjen e punimeve të prishjes së elementëve ekzistues prej betoni, sipas zërit nr. 1 të preventivit.

6-Fadromë nevojitet për realizimin e punimeve të gërmimit, ngarkimit dhe sistemimit të materialeve sipas zerave nr. 4–10 të preventivit, veçanërisht në zonat ku ekskavatori nuk mund të operojë në mënyrë efektive.

7-Autobot për spërkatje uji nevojitet për lagjen e rrugëve dhe sipërfaqeve të punës, kontrollin e pluhurave gjatë gërmimeve dhe transportit të materialeve, si dhe për krijimin e kushteve të përshtatshme të punës në kantier.

8-Kompaktues / Tokmak vibrues nevojitet për ngjeshjen e shtresave të mbushjes dhe të nënshtresave sipas kërkesave teknike të projektit dhe specifikimeve teknike.

9-Vibrator betoni nevojitet për vibrimin dhe kompaktësimin e betonit të freskët gjatë realizimit të strukturave prej betoni, me qëllim eliminimin e boshllëqeve dhe garantimin e cilësisë së betonit.

10-Pajisje topografike (Total Station dhe/ose GPS) Nevojitet për kryerjen e rilevimeve topografike, piketimin e objektit, kontrollin dhe ndjekjen e kuotave, akseve dhe dimensioneve sipas projektit të zbatimit.

2.3.10 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Certifikatë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- Certifikatë ISO 45001 - 2018 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;

- Certifikatë ISO 14001:2015 ose 14001: 2026 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- Operatori duhet të disponojë Liçense leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe urbane jo të rrezikshme), të vlefshme së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme janë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar,ku përcaktohet se:“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Me anë të këtij kriteri kerkohet qe OE te deshmojne se plotesojne standartet e kerkuara te cilesise, standartet per shendetin dhe sigurine ne pune dhe standartet e menaxhimit te mjedisit

ISO 9001:2015 ose ekuivalente, është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 ose ekuivalente, me qëllim

efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ose 14001:2026 ose ekuivalente, ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 ose ekuivalente, është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatën 45001-2018 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Kërkesa për licencën Kodi III 2 B e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji” dhe VKM Nr.402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”. Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta: Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim në vëmendje se:

- Dokumentet përkatëse vërtetuese për disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jete kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Dokumentacioni teknik ku perfshihen Specifikimet Teknike, Projekti, Preventivi dhe Grafiku i Punimeve per këtë objekt jane dorëzuar nga nga Studio e Projektimit HMK Consulting Shpk e cila është kontraktuar nepërmjet shërbimit te konsulences nga Bashkia Devoll me kontratën nr 22. Dt. 02 .08. 2022 me objekt ” Hartim projekti ”Rehabilitimi i Kanalit të Kallabaqit Bitince” Projekti është hartuar dhe është marre në dorëzim nga Bashkia Devoll ne perputhje me legjislacionin përkatës.

Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b, dhe nenit 36 të LPP (*e ndryshuar*), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit*” i ndryshuar.Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.Gjate hartimit te specifikimeve teknike jane marre ne konsiderate kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese të përcaktuara në aktet në ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit.E

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili është publikuar se bashku me dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT: